



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1182/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Qerim Hasani, vëzhgues nga radhët e PDK-së në Lipjan, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të manipulimit me vota, për Zgjedhjet Lokale në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Qerim Hasani vëzhgues nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në Lipjan.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 03.12.2013 në ora 14:57 nga Qerim Hasani ku ka pretenduar se në vendvotimin nr:1304e si vëzhgues i PDK-së kam parë falsifikimin e FPR-ve nga komisionerët e PDK-së ku kandidatëve nuk u janë shënuar drejt votatë e fituara por i janë shënuar kandidateve te tjerë te preferuar, dhe po ashtu gjate plotësimit të FPR-ve më kanë larguar nga vendvotimi, thuhet në pretendimet e ankuesit. Parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi ankesën gjeti se:

ankesa është e pabazuar

PZAP-i, konstatoi nga shkresat e lëndës se pretendimet ankimore të vëzhguesit Qerim Hasani janë të pa argumentuara në fakte dhe dëshmi konkrete pasi qe ankesës në fjalë nuk i ka bashkangjitur asnjë dëshmi bindëse, për tu vërtetuar për shkeljen e supozuar andaj ankesa vlerësohet si e pa bazë, duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 1182/2013 më datën 06.12.2013.

**Kryesuesi i Panelit
Ferit Osmani**



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.